

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Filozofik-Departamenti i Historisë</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Histori e Evropës Juglindore III</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Viti i tretë (III), semestri VI</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>7</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof.Asoc.Dr. Selim Bezeraj</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Kjo lëndë ofron njohuri themelore mbi ngjarjet, fenomenet dhe proceset historike që u shënuan të popujt e Evropës Juglindore gjatë shek. XIX-XX. Vëmendja themelore do të përqendrohet në fenomenet nga fusha e zhvillimit të mendimit politik, shoqëror, kulturo-arsimor, religjionit, rregullimit politik, diplomacisë, ekonomisë etj. Shek. XIX-XX shënoi për popullin shqiptar, ashtu si edhe për popujt tjerë të Ballkanit, një epokë të re, atë të luftës për pavarësi nga P. Osmane. Kjo periudhë ka hyrë në historinë moderne të vendeve të Ballkanit si shekulli i lëvizjeve dhe i revolucioneve kombëtare, që ndoqën njëri-tjetrin dhe që çuan në çlirimin e shumicës së popujve të këtij gadishulli nga sundimi i P. Osmane dhe në formimin e shteteve të pavarura. Këto lëvizje u zhvilluan në kushtet e dekadencës së Perandorisë Osmane, të shthurjes së marrëdhënieve të vjetra feudale dhe të lindjes së ekonomisë së tregut, të zgjimit të mëtejshëm të ndërgjegjes kombëtare të popujve të këtij gadishulli dhe të zgjerimit të ndërhyrjeve të Fuqive të Mëdha në këtë Perandori por edhe tek disa vende të Ballkanit. Në fokus do të ketë edhe marrëdhëniet e popujve të E. Juglindore dhe shqiptarëve me Perandorinë Osmane dhe me Fuqitë e mëdha të kohës, Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike, pavarësia e Shqipërisë, Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore zënë vend të theksuar në materien e lëndës. Një dimension i veçantë i kushtohet periudhës së instalimit të diktaturës komuniste</p>

	të shteteve të rajonit të Evropës Juglindore pas LDB.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve, do të synohet që studentët jo vetëm të marrin informacionin e duhur, por edhe të nxiten për diskutime dhe analiza të pavarura rreth tematikës që do të shtjellohet gjatë procesit mësimor. Përmes kësaj metodologjie studentët do arrijnë të i kuptojnë zhvillimet politike dhe kulturore në kohën e konsolidimit të kombeve në Ballkan dhe të kombit shqiptar. Pas përfundimit të këtij kursi studentët do mund të njohin më mirë Historinë e Evropës Juglindore në shek. XIX-XX, do të aftësohen për të bërë analiza dhe kritika me qëllim të vlerësimeve sa më të drejta historike, do njohin më mirë edhe politikën por edhe diplomacinë e Fuqive të Mëdha dhe popujve ballkanik dhe të shqiptarëve.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p><i>Nga kjo lëndë studentët:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Do ta kuptojnë dhe do të mësojnë ta interpretojnë drejtë fenomenin e ngritjes së vetëdijes kombëtare të popujve të Evropës Juglindore dhe çështjes shqiptare në Ballkan, në raport me rrethanat e kohës.</li> <li>• Do ta kuptojnë ndërlidhshmërinë dhe komperacionin e fenomeneve ekonomike, sociale, kulturore, politike dhe religjioze në Ballkan.</li> <li>• Do të jenë në gjendje t'i kuptojnë fenomenet e ndryshme shoqërore të asaj kohe dhe qëndrimin e Fuqive të Mëdha ndaj vendeve dhe popujve të Ballkanit.</li> <li>• Do të mund të analizojnë dhe të krahasojnë raportet e diplomacisë ndërkombëtare sa i përket çështjes së Ballkanit dhe të shqiptarëve para dhe pas kongresit të Berlinit 1878.</li> <li>• Do të mësojnë për burimet dhe tekstet historike kompetente që përshkruajnë zhvillimet dhe ndodhitë më të rëndësishme historike të Evropës Juglindore përgjatë gjithë shek. XX-të.</li> <li>• Do të aftësohen për të kuptuar dhe interpretuar realitetin gjeopolitik si dhe</li> </ul>

	efektet e ngjarjeve historike gjatë shek. XX-të në vendet e Evropës Juglindore.		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	3	15 javë	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15 javë	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.40	10 javë	4
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume, seminare	2	4 javë	8
Detyra të shtëpisë	6	1 javë	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15 ditë	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15 ditë	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, seminare, ese, provim final)	2	1 javë	2
Projektet, prezantimet, etj	2	10 javë	20
<b>Totali</b>			<b>175:25= 7 ECTS</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>-Punë teorike e kombinuar me ligjërata dhe prezantime të studentëve në trajtimin e historisë së Evropës Juglindore gjatë shek. XIX-XX me të gjitha specifikat që ngërthen në vete.</p> <p>-Ligjërata(të formës së kombinuara – interaktive),</p> <p>-Ushtrimet (Hartimi i punimeve shkencore diskutimi i tyre ne grupe dhe komunikimi Interaktiv lidhur me punimet e studentëve),</p>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Kollokfiumi i parë: 20%</p> <p>Kollokfiumi i dytë: 40%</p> <p>Përgatitja e seminareve: 30%</p> <p>Pjesëmarrja në ligjërata 10%</p> <p><b>Totali 100%</b></p>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	<p>Georges Castellan, <i>Histori e Ballkanit</i>, Prishtinë: Gutenberg, 1996;</p> <p>Misha Glenny, <i>Histori e Ballkanit 1804-1999, Nacionalizmi, luftërat dhe Fuqitë e Mëdha</i>, Tiranë: Toena, 2007;</p>		

	<p>Abaz Mullai, <i>Historia e Ballkanit shek. XIX-1918</i>, Tiranë: SHBLU, 2008;</p> <p>Charls &amp; Barbara Jelavich, <i>Themelimi i shteteve kombëtare të Ballkanit 1804-1920</i>, Tiranë: Dituria, 2004;</p> <p>Ferdinand Schevill, <i>Ballkani: historia dhe qytetërimi</i>, Tiranë: Uegen, 2002;</p> <p>Joseph Rothschild, <i>Evropa Lindore Qendrore midis dy luftërave botërore</i>, Tiranë: Dituria, 2004;</p> <p><i>Historia e popullit shqiptar</i>, III&amp;IV, Tiranë: Toena, 2002;</p>
Literatura shtesë:	<p>Literatura e autorëve të huaj:</p> <p>Noel Malkolm, <i>Kosova- një Histori e shkurtër</i>, Prishtinë: KOHA, 2001.</p> <p>Stanford J. Shaw, <i>Historia e Perandorisë Osmane dhe e Turqisë Moderne</i>, Tiranë: Jehona Study Center, 2006.</p>

#### Plani i dizajnuar i mësimi:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Njohja me Lëndën, Burimet dhe Literatura, Vështrim i Përgjithshëm mbi periudhën që e karakterizon Historinë e Evropës Juglindore në shek. XIX-XX
<i>Java e dytë:</i>	Revolucionet në E. Juglindore në fillim të shek. XIX
<i>Java e tretë:</i>	Principata e pavarura në E. Juglindore 1821-1833
<i>Java e katërt:</i>	Lëvizja nacionale në Mal të Zi në shek. XIX
<i>Java e pestë:</i>	Shqiptarët në fillim të shek. XIX-1847
<i>Java e gjashtë:</i>	Mbretëria Greke (1833-deri në vitet 70-ta në shek. XIX)
<i>Java e shtatë:</i>	Revolucioni në Principatat Danubiane
<i>Java e tetë:</i>	Kollokfiumi 1
<i>Java e nëntë:</i>	Formimi i shtetit rumun dhe Lëvizja kombëtare në Bullgari në shek. XIX
<i>Java e dhjetë:</i>	Reformat osmane: krizat në Evropën Juglindore dhe nacionalizmi
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Evropa Juglindore gjatë viteve 1908-1918
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Formimi i shtetit shqiptar dhe zhvillimet në Ballkan
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Jugosllavia dhe Turqia pas LPB
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Evropa Juglindore gjatë LDB
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Zhvillimet në Ballkan-Komunizmi dhe Lufta e Ftohtë

#### Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Hyrja me kohë në ligjërata - e domosdoshme;
- Telefonat celularë shkyçen para se të fillojë procesi mësimorë;
- Kopjimi gjatë provimit - i ndaluar dhe ndëshkohet;

**Çdo kontakt me profesorin e lëndës lidhur me çështjet që dalin nga lënda përkatëse  
- nëpërmjet e-mail adresave, ditëve të parapara për.**

***\* Statuti i Universitetit të Prishtinës i cili është në fuqi parasheh politikat e mirësjelljes  
dhe misionin e universitetit.***